



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada – Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit
611-25-4758-2-3-6/C862



K O N T R A T Ë /SHERBIM

Emri i Projektit: **Mirembajtja e Objektivit të SHZSH-se në Gllobare**

Numri identifikues: : **611-25-4758-236** , Datë: 17.07.2025; Nr. i arkivit; **400-01/- 37463**

PALET NË MARRËVESHJE

KOMUNA E DRENASIT - Drenas, përfaqësuar nga **GENTIANA QELA** Zyrtar i Prokurimit (më tutje "Punëdhënësi").

" IZO - H " SH.P.K., Idriz Gjilani SU-5/ Nr.431 A/-1, Prishtine, 810105842,, përfaqësuar nga **IZEDIN HOTI**
Neni 1 Ligji i aplikueshëm

1.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë Ligji Nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237. Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 2 Lënda

Lënda e kontratës duhet të jetë : **Mirembajtja e Objektivit të SHZSH-se në Gllobare**

Kontraktuesi duhet të jetë në pajtueshmëri të plotë me afatet e Kushteve të kontratës dhe të aneksit teknik, duke përfshirë të gjitha ndryshimet në variantin e propozuar.

2.1 Vendi i pranimit të **shërbimeve** do të jetë: Komuna e Drenasit, Inkotermi i zbatueshëm do të jetë DDP¹. Periudha e kryes së punëve/**shërbimeve** dhe furnizimeve do të jetë deri në afatin : **10 dite**.

Neni 3 Çmimi

Çmimi i furnizimeve është në shumën prej: **2,655.50€**; [*Dymijë e Gjashtëqindë e Pesëdhjetë e Pesë euro e 50 cent*]

3.1 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas bersës përkatëse)

3.2 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e kontratës

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesa do të kryhet çdo herë kur raporton menaxherit të projektit.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

4.3 Kryetari i komunës, Autorizohet në bazë të Nenit 81 të Ligjit Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 të caktot me një vendim, Menaxherin e Projektit zyrtarin me përvojë në profesion dhe mundësisht nga Krytari i Komunes.

4.4 Komisionin për pranim i caktojnë Njësit kërkuese. Afati i kryerjes së **sherbimeve** duhet të jetë brenda **10 dite**. Pranimi duhet të kryhet konform neneve të kontratës dhe duhet të jetë konform Pjesës IV, Nenit 81, pika 1, 2 dhe 3 të Ligjit mbi Prokurim Publik Nr. 04/L-042 dhe dokumentacionit dytësor. Monitorimin e kësaj kontrate dhe pjesët e Planit të Menaxhimit e kryen DSHPE ..

- a) Të gjitha pagesat kryhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës, të **sherbimeve** të kryera do të caktohet nga menaxheri Poashtu zyrtari për pagesë para se të kryhet pagesa duhet të bindet se fatura është konform kërkesës dhe çmimorës që është pjesë e kontratës. Çdo faturë duhet të pranohet nga Menaxheri i Projektit.
- b) Të gjitha dokumentet si: aktvendimet, procesverbalet, raportet për **sherbimeve** të kryera, faturat, shkresat, etj. duhet të dorëzohen tek Zyrtari për pagesë.
- c) Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rreth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblertjes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkuara nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i furnizimeve/**shërbimeve**/punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit., dhe në pajtim me Menaxherin e caktuar nga Krytari i Komunes.

Neni 7 Garancioni i sherbimeve

7.1 Garancioni kerkohet me valaditet prej **Një viti**.

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat] [të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet] [te kryej ndonjë ose të gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [**sherbimeve**] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi dhe caktimi i menaxherit

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik **shtatë ditë** paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e res-judikata; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e res judicata për mashtrim,

korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në pajtim me ligjin e Kosovës, **Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.**

Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën **Shqipe** në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.
Pjesë e ofertës është paramasa dhe paralogaria e ofertuesit. Kontrata hynë në fuqi me menjehere pas nënshkrimit. .

Për Autoritetin Kontraktues		Për Kontraktuesin	
Emri:	GENTIANA QELA	Emri:	IZEDIN HOTI
Pozita:	ZPP	Pozita:	DREJTOR
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:		Data:	01.09.2025
Vula:		Vula:	



Lloji i Garancisë: Garanci Kontrate

Për

Seria |

10001249769

KOMUNA GLLOGOC

(emri i Autoritetit Kontraktues, në tekstin e mëposhtëm Autoriteti Kontraktues)

DUKE PASUR PARASYSH QË

IZO-H SH.P.K

(emri i operatorit ekonomik, në tekstin e mëposhtëm "Operatori Ekonomik")

ka marrë përsipër të lëshoj një sigurim të realizimit lidhur me kontratën me titull

Mirembajtja e Objektivit të SHZSH-se në Gllobare

të dhënë me numrin e Prokurimit

611-25-4758-2-3-6

(Nr. i referencës së prokurimit)

për Operatorin ekonomik nga Autoriteti Kontraktues;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË Operatori Ekonomik dëshiron të lëshojë një garanci për shumën e sigurimit e specifikuar në dosjen e tenderit nën numrin e dhënë të prokurimit;

DHE DUKE PASUR PARASYSH QË jemi pajtuar t'i japim Operatorit Ekonomik këtë garanci:

PËR KËTO ARSYE vërtetojmë që ne jemi Garantues dhe përgjegjës ndaj juve, në emër të Operatorit Ekonomik, deri në një shumë totale prej

265.55 €

Dy Qind e Gjashtëdhjetë e Pesë Euro e Pesëdhjetë e Pesë Cent

(shuma e garancisë në numra dhe në fjalë)

dhe ne marrim përsipër të ju pagujmë, me kërkesën tuaj të parë me shkrim që deklarohen që Operatori Ekonomik ka bërë gabim sepse:

- Autoriteti kontraktues është konfrontuar me humbje substanciale që janë rezultat i dështimit të Operatorit Ekonomik për të kryer obligimet e veta sipas kontratës; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo shkakton dëm të konsiderueshëm të Autoritetit kontraktues dhe/ose kërkon nga Autoriteti kontraktues të bëjë shpenzime të konsiderueshme për realizimin e kësaj kontrate; dhe/ose
- Operatori Ekonomik e ka shkelur kontratën e nënshkruar, dhe kjo ka lënë pa pagesë shumë punëtorë, nënkontraktues, dhe/ose furnizues material; ose
- Ofertë jonormalisht e ulët e dorëzuar nga Operatori Ekonomik zbulon që kjo ofertë nuk mund të realizohet dhe pa asnjë ankesë ose argument, të gjitha shumatat brenda limiteve të

265.55 €

(shuma e garancisë)

siç është thënë më lart, pa pasur nevojë që të dëshmohet ose të jepen arsyet ose bazat për kërkesën tuaj ose për shumën e specifikuar këtu.

Kjo garanci është e vlefshme prej datës

27.08.2025

deri më

27.10.2025

Lëshuar në

Prishtinë

datë

27.08.2025

Nënshkrimi dhe vula e Garantuesit

PRISHTINË



Kompania e Sigurimeve PRISIG SH.A / Numri unik identifikues: 810842832 / Tel: +383 (0) 38 221 000

Email: info@prisig-ks.com / www.prisig-ks.com / Adresa: Rr. Eduard Lir 173 Lagjia Arbëria, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës

**PARAMASA DHE PARALLOGARIA PËR RENOVIMIN E OBJEKTI (Kulmit) TË SHËRBIMIT TË
ZJARRFIKËSVE NË DRENAS**

A Punët në rregullimit të kulmit shtësë të SHZSH				
	Pjerrtësia e kulmit te objektit duhet te jete siqë është ajo ekzistuese	Njesia	Sasia	çmimi çmim total
1	Furnizimi me material si dhe punimi i konstruksionit të kulmit me traje druri. Trajet me dimensione 12x12 cmxcm dhe gjatësi 5m dhe të punohen në përputhje me gjendjen egzistuese të kulmit ku materiali i përdorur duhet të jetë dru i klasit të parë me lagështi më të vogël se 15%. Konstruksioni duhet të jetë i ankeruar me bulona me L=20 cm në cdo 0.75 m' në trajet ekzistuese nga beton armeja të me mbështetje të përshtatëshme për bartje të ngarkesave.Në cmim të llogaritet edhe lyerja me baz dhe ngjyrë druri.Trajet duhet të jenë të struguara.	m³	0.80	250.00 200.00
2	Furnizimi me material si dhe punimi i konstruksionit të kulmit me traje druri. Trajet me dimensione 14x14 cmxcm ,ku përfshihet trajet horizontale me gjatësi 9 m, ku njëri tra përforcohet për muri me ankerim me mbajtëse metalike dhe tjetri tek trajet vertikale dhe 8 trajet vertikale me gjatësi 2.10 m(4 traje tek muret dhe 4 te tjere tek pjesa ku vendoset kulmi).Në cmim të llogaritet mbajtset metalike edhe lyerja me baz dhe ngjyrë druri. Trajet duhet të jenë të struguara	m³	0.75	250.00 187.50
3	Furnizimi dhe material dhe montimi i listellave me dimensione 3x5 cm me gjatesi 9 m, dhe llogaria behet me m', ankerimi i listellave behet me bulona me gjatesi 15 cm, ne trajet 10x12 cm	m'	60.00	4.00 240.00
4	Furnizimi dhe material dhe montimi i llamperive të struguara me dimensione 2x10x10 cm me gjatesi 9 m, dhe llogaria behet me m', ankerimi i llamperive behet me bulona me gjatesi 3 cm, ne trajet 12x12 cm.Në cmim të llogaritet edhe lyerja me baz dhe ngjyrë druri në anën e mbrendëshme të kulmit.	m²	45.00	6.00 270.00
5	Furnizimi me material si dhe mbulimi i kulmit me llamarin te plastifikuar 0.5mm e cila duhet të jetë e vazuara dhe e njejt me ngjyren e llamarinës ekzistuese. Në cmim të parashiher të gjitha materialet shoqeruese, bulona, goma izoluese	m²	45.00	20.00 900.00
6	Furnizimi dhe Montimi i ulluqeve horizontale dhe vertikale Ø 100 mm, komplet me kthesa 90° dhe 45°	m'	14.30	20.00 286.00
7	Furnizimi dhe montimi i mbajtësve metalike për traje vertikale(8 copë) dhe horizontale(4 mbajtëse në muri), cmim te hyn komplet edhe bulonat adekuat.	copë	12.00	15.00 180.00
8	Hapja e gropave me dimensione 0.4x0.3 m dhe betonimi i tyre dhe vendosja e bazamenteve metalike per vendosje te trajeve vertikale 14x14 cm, ku bazamentet duhet të jenë me pllaka metalike dhe me kater ankera.Pra ne qmim të hyn edhe germimi i dheut dhe betonimi i pllakave metalike dhe kthimi i kubzave në gjendjen paraprake.	copë	8.00	25.00 200.00
9	Furnizi dhe montimi i dy prizave një fazore dhe tre trupave ndriqes rrethor LED(25x30)cm, komplet me kabell, 13 m për qdo shpenzues dhe një ndërpresë.	copë	6.00	32.00 192.00
Totali për RENOVIMIN E KULMIT				2,655.50

TOTALI I PËRGJITHËSHEM				
A	Punët në rregullimit të kulmit shtësë të SHZSH			
	TOTALI			2,655.50
				2,655.50

VËREJTE: ËSHTË E OBLIGUESHME QË OPERATORET TË DALIN NË VIZIT NË
LOKACIONIN E OBJEKTIT TË SHZSH NË DRENAS, GJATË FAZES SE
OFERTIMIT

Plani Dinamik- 15 nga dita e nënshkrimit të kontratës

Afrim Prokshi, Ing dipl.

